



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	14.01	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SHK	146/2021		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.02/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.02/2020 të datës 03.01.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë, Rruga "Mbretëresha Teute" nr.62 në Komunën e Mitrovicës, kundër organit të punësimit-Shërbimit Korrektues të Kosovës në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.02/2020 e datës 03.01.2020 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bazë të Autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil të Kosovës të datës 09.08.2019, me datë 14.08.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar për Aftësim Profesional", në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë). Shërbimi Korrektues i Kosovës pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, më datë 06.11.2019 ka publikuar rezultatet e procedurës, në bazë të cilit njoftim ankuesi nuk është kandidat i përzgjedhur në pozitë "Zyrtar për Aftësim Profesional".

Ankuesi kundër njoftimit të datës 06.11.2019, ka parashtruar ankesë me datë 21.11.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 04.12.2020 ka nxjerr vendimin me të cilin e ka shpallur veten jo-kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit të datës 21.11.2019.

Ankuesi duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.01.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër protokolli 05/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.01.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 16.01.2020 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 03.01.2020 me numër protokoll 05/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 04.12.2019; Ankesa e ankuesit e datës 21.11.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Diploma e ankuesit e datës 06.10.2017 me numër:1541/17; Diploma e datës 25.01.1997 me numër 1-74/97; Çertifikatë falënderimi e datës 26.11.2003; Mirënjohje e datës 25.05.2018; letërnjoftimi i ankuesit; Çertifikatë e datës 07.11.2017; Kopja e konkursit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 10.01.2020; Përgjigja në kërkesë e datës 16.01.2020; Njoftimi i datës 06.11.2019; vendimi i datës 04.11.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Shkresa e datës 27.09.2019; Formulari Form.MAP-SHCK-11 për Raportin Final të Rekomandimit nga Komisioni Rekrutes i datës 25.09.2019; Përmbledhja e vlerësimeve Individuale; Renditja Përfundimtare e Kandidatëve; Pyetje e parashtruara nga komisioni përzgjedhës në intervistën me gojë; Formulari për vlerësimin individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Përcaktimi i kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Qelësi i pyetjeve të testit me shkrim; testi me shkrim i kandidatit të përzgjedhur; Testi me shkrim i ankuesit; Lista përfundimtare e përzgjedhjes për listën e ngushtë, Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Kriteret e zgjedhjes së ngushtë; Regjistri i kërkesave të pranuar sipas librit të pranimit; Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës; kërkesa për punësim e kandidatit të përzgjedhur e datës 15.08.2019; Diploma e datës 29.11.2011 me numër:470; Çertifikatë e periudhës mars 2013; Mirënjohje e datës 07.03.2009; Mirënjohje e datës 17.06.2011; Mirënjohje e datës 07.03.2016; Çertifikatë e periudhës maj-qershor 2016; Vërtetimi i datës 09.06.2008; Çertifikatë me numër 526/08; Vërtetim i datës 01.12.2008; Shkresë e datës 21.05.2012; Shkresë e datës 11.07.2012; Shkresë e datës 24.11.2007; Çertifikatë e datës 04.06.2006; Çertifikatë e datës 12.06.2006; Çertifikatë e datës 23.04.2006; Çertifikatë e datës 25.12.2005; Shkresa e Universitetit të Prishtinës e datës 15.04.2013 me numër të vulës zyrtare 403/32; Vërtetimi i datës 26.07.2017; Çertifikata e lindjes e kandidatit të përzgjedhur; Cv-ja e kandidatit të përzgjedhur; letërnjoftimi i kandidatit të përzgjedhur; kërkesa për punësim e ankuesit e datës 24.08.2019; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2018; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2017; Diplomë me numër protokoll 330/1996; Letërnjoftimi i ankuesit; Kopja e kartelës për student e ankuesit; Diploma e datës 06.10.2017 me numër 1541/17; Autorizimi i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil të Kosovës i datës 09.08.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e palejuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që ankuesi me datë 03.01.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka pranuar njoftimin e datës 06.11.2019 të publikuar nga procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Aftësim Profesional, që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"**, që në rastin konkret ankuesit ka filluar të rrjedh afati për ankimim në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është atëherë kur ankuesi ka pranuar njoftimin e datës 06.11.2019 të publikuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se ankesa e ankuesit është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka vlerësuar se nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit, por ka vendosur njëzëri që ta hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit të datës 03.01.2020 me numër Anr.02/2020 të protokolluar 05/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil

të Kosovës, në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se më datë 11.09.2019 ka hyr në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mbi këtë bazë janë shfuqizuar dhe të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional, ndërsa pas zgjedhjes së pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shqyrtimit të bazës ligjore, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbledhjen e katërt të mbajtur më datë 09.11.2020 nxjerr Vendim me Nr. 9/2020 me të cilin është vendosur që të gjitha ankesat e dorëzuara dhe ato të kthyera në rishqyrtim nga gjykata do të vendosen nga Këshilli.

Secila palë që ka mundur të hap konflikt administrativ si pasojë e mos veprimit të KPMSHCK-së duhet të veproj konform dispozitës së shënuar më poshtë të Ligjit për Konfliktin Administrativ i cili përcakton si vijon: Neni 36 1. Nëse organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, si dhe në rastin nga neni 29 i këtij ligji nxjerr më vonë aktin administrativ, ky organ, përpos paditësit, do ta njoftojë edhe gjykatën. 2. Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të deklarojë nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm: 2.1. është i kënaqur; 2.2. nuk heq dorë nga padia; 2.3. pjesërisht heq dorë nga padia; 2.4. ai/ajo padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër. 8 3. Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerr në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk e jep deklaratën brenda afatit nga paragrafi 2. i këtij neni, gjykata do të nxjerrë vendimin mbi pezullimin e procedurës. 4. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është ai/ajo i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.02/2020

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtarë e Dartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesi
- Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

